



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE**

---



**FTESË PËR PJESËMARRJE**

**DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE  
DEGA E GJUHËS RUSE**

**ORGANIZON  
SIMPOZIUMIN SHKENCOR NDËRKOMBËTAR**

**ME TEMË:  
«DOSTOJEVSKI DHE GJENIALITETI I TIJ»**



**06 QERSHOR 2023, FGJH  
SALLA “EUROPA”, ora 09:00**



**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE**

---



Ftojme të gjithë studiuesit, pedagogët, doktorantët, studentët pasuniversitarë, përkthyesit dhe të interesuarit, të marrin pjesë në Simpoziumin Shkencor Ndërkombëtar me temë: «**DOSTOJEVSKI DHE GJENIALITETI I TIJ**», i cili do të organizohet më 06 Qershor 2023.

*Ky simpozium mbahet për nder të dyqindvjetorit të lindjes së shkrimtarit të madh rus F.M.Dostojevskit, vepra e të cilit ka ardhur e plotë në gjuhën shqipe, si edhe duke marrë parasysh kontributin e jashtëzakonshëm të shkrimtarit në letërsinë ruse dhe botërore, dhe vlerësimin e UNESCO-s, si një nga autorët rusë më të cituar dhe më të përkthyer në botë, trashëgimia e të cilit studiohet në shkolla, universitete, si dhe nga shkencëtarë të profileve të ndryshme. Ky simpozium shkencor ndërkombëtar, i kushtohet perceptimit të veprës së shkrimtarit të madh në kulturën botërore. Rëndësia e kësaj ngjarje vlerësohet për faktin, se vepra e shkrimtarit të madh pasqyron jo vetëm të kaluarën e njerëzimit, por edhe të ardhmen e tij. Prandaj, duke studiuar Dostojevskin sot, mund të kuptohen perspektivat për zhvillimin e njerëzimit në të ardhmen. Në këtë simpozium është menduar një pjesëmarrje më e gjerë e studiuesve si brenda vendit por edhe jashtë tij, duke e konsideruar Dostojevskin si një kompleksitet në rrafshin gjuhësor, letrar, filozofik, kulturor dhe jo vetëm. Përkthimet e veprës së tij në gjuhë të ndryshme dhe gjetja e veprës së plotë të tij në gjuhën shqipe, bëjnë të mundur studime interesante edhe në fushën e përkthimit.*

**Nëntemat e konferencës:**

- **Trashëgimia e F. M. Dostojevskit në kulturën dhe historinë botërore dhe ruse;**
- **Dostojevski në mendimin fetar dhe filozofik;**
- **Ndikimi i Dostojevskit në modernizmin rus;**
- **Dostojevski dhe filozofia evropiane e shekujve 19-20;**
- **Poetika e prozës së F. M. Dostojevskit (narracioni, zhanri, stili);**
- **Dostojevski në mendimin fetar dhe filozofik rus të epokës së argjendit;**
- **Faqe të panjohura të jetës dhe veprës së F. M. Dostojevskit;**
- **Dostojevski në paradigmen arsimore;**
- **Dostojevski dhe vetëdija gjuhësore ruse;**
- **“Ditari i një shkrimtari” si fenomen letrar dhe filozofik;**
- **F. M. Dostojevski dhe artet e bukura. Shkrimtar si kritik arti;**



**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE**

---



- Dostojevski dhe letërsia botërore;
- Dostojevski dhe letërsia ruse;
- Dostojevski në Shqipëri;
- Dostoevski në fatin e njerëzve të shekullit XX;
- Veçoritë e gjuhës dhe stilit të Dostojevskit;
- Dostojevski në përkthime në gjuhë të ndryshme;
- Dostojevski me sytë e të rinjve (platformë diskutimi për të rinjtë).

Ky simpozium do të mbahet në Tiranë më 6 Qershor 2023 dhe punimet/abstraktet do të publikohen në Tiranë, Shqipëri.

Gjuhët referuese do të jenë shqip, rusisht dhe anglisht.

Jeni të mirëpritur dhe për pjesëmarrje virtuale. Nuk është e nevojshme pjesëmarrja fizike për ata që paraqesin poster dhe/ose prezantime video-konferencash.

Veprimtaria shkencore organizohet nga Dega e Gjuhës Ruse, Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës (Shqipëri), me pjesëmarrje dhe mbështetje të kolegëve nga universiteti shtetëror M.V. Lomonosov, Moskë.

#### **DATA DHE AFATE TE RËNDËSISHME**

Dorëzimi i abstrakteve:	Deri më <b>25 Maj 2023</b>
Pranimi i abstrakteve:	<b>28 Maj (konfirmimi)</b>
Mbajtja e simpoziumit:	<b>06 Qershor 2023</b>
Dorëzimi i punimeve të plota për publikim:	Deri më <b>20 shtator 2023</b>

#### **Të dhëna për dërgimin e abstrakteve:**

- *Abstraktet e punimeve në shqip dhe anglisht mund t'i dërgoni në adresën: [konferencedostojevski@gmail.com](mailto:konferencedostojevski@gmail.com).*
- *Abstrakti duhet të jetë në formatin "Word", me jo më shumë se 250 fjalë.*
- *Për pranimin e abstraktit do të njoftoheni më 17 Maj 2023.*

#### **Abstrakti duhet të përfshijë:**

- *Titullin e kumtesës (të theksuar, të qendëruar, me shkrim "TimesNew Roman", madhësia 14);*
- *Emrin e autorit (titullin e tij shkencor, institucionin ku është i punësuar, adresa e "e-mail"-it, madhësia 11);*



**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE**

---



- *Tekstin (shkrimi i përdorur: "TimesNew Roman", madhësia 12, "margjina" normale, hapësira "single"*
- *Fjalët kyçe (maksimalisht 5, madhësia 11, me shkrim të pjerrët).*

Për më shumë informacion ju lutemi kontaktoni në e-mailin

[konferencedostojevski@gmail.com](mailto:konferencedostojevski@gmail.com).

**Koordinatorë e konferencës:**

Prof.Asoc.Dr. Alma Pinari

**Bordi organizativ**

Prof.Asoc. Dr. Alma Pinari

Prof.Asoc. Dr. Adriatik Derjaj

Prof.Asoc. Dr. Eda Shehu

Prof.Dr. Olga Sinjova

Prof.Asoc. Xhemile Abdiu

Dr. Olena Zoto

Msc. Elvira Xhamani

**Përgjegjëse e Degës së Projekteve: Vasilika Bezhani**

**Bordi shkencor:**

Prof.Dr. Esmeralda Kromidha

Prof.Asoc.Dr. Adriatik Derjaj

Prof.Asoc.Dr. Alma Pinari

Prof.Asoc.Dr. Eda Shehu

Prof.Asoc.Dr. Raqi Bello

Asoc.Prof.Dr.Xhemile Abdiu

Asoc.Prof.Dr. Spartak Kadiu

Dr. Alban Foçi

Dr. Olena Zoto

Msc. Elvira Xhamani

**Alumni:** Msc. Gentjan Doçi

**Sekretare:** Klodeta Dervishi